

Masat e reja që deklaroi Qeveria, dje të **Martën më 28 Prill** janë në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Në përgjithësi

-**Shfuqizohet sms-i** dhe qarkullimi tashmë do të jetë i lirë.

-Prej datës **18 Maj do të lejohet lëvizja nga një rajon në një tjetër.**

-**Kishat do të hapen më 4 Maj për lutje personale** dhe më **17 Maj** për të gjithë besimtarët, gjithmonë me masa sigurie.

Plazhet e organizuara do të mbeten të mbyllura.

-**Vazhdon leja për qëllim të posaçëm**, e cila vijon në varësi të progresit të hapjes së shkollave. Vijon edhe leja e posaçme për grupet me rrezikshmëri të lartë.

Hollësisht:

1)Masa të higjienës personale

-**Përdorimi i maskës është i detyrueshëm** në të gjithë ambientet e mbyllura si: Mjete të Transportit Publik, dyqane, spitale, parukeri, dyqane berberi, qendra estetike, qendra diagnostike, etj. Mosrespektimi i masës do të gjobitet me 150 Euro.

2)Mjete të Transportit Publik.

-**I detyrueshëm do të jetë përdorimi i maskës mbrojtëse në lëvizjet me mjetet e transportit publik nga punonjësit dhe pasagjerët.** Hyrja në stacione do të jetë e kontrolluar në mënyrë që të arrihet distanca fizike e nevojshme dhe rritja e frekuencës së itinerareve në maksimum.

Më hollësisht:

-Synimi kryesor është të shkurtohet koha e pritjes në mjetet e transportit publik.

-Mbingarkesa e automjeteve gjatë orëve të pikut, do të shoqërohet njëkohësisht nga **ulja e frekuencës së hyrjes në periudhat ndërmjetëse**, domethënë prej orës 10 te mëngjesit deri në orën 2 të mesditës dhe prej orës 6 të pasdites deri në mesnatë.

- Për taksitë vazhdon zbatimi i rregullit që është në fuqi edhe sot, domethënë shoferi dhe një pasagjer, me përjashtimet e njohura të transportit të prindit me fëmijë të mitur ose shoqërim personi për arsye mjekësore.

3)Dyqanet

- **Më 4 Maj** fillojnë punën dyqanet e tregtisë me pakicë (libraritë,dyqanet optike,pajisje sportive,shitje bimësh,tregjet e konsumit dhe çlirohet qarkullimi i prodhuesve për tregjet fshatare ndërmjet rretheve) dhe **biznesi i shërbimeve** (parukeri,dyqane berberi,qendra estetike).

-Dyqanet e tjera do të fillojnë punën të **Hënën më 11 Maj**, përveç qendrave tregtare.

-**Më 1 Qershor**,funksionojnë sërish qendrat tregtare,restorantet dhe lokalet në **ambient të jashtëm** në një distancë prej 2 metrash dhe 4 personash për tavolinë.

-**Gradualisht do të fillojnë të funksionojnë sërish parqet e kohës së lirë**, parqet e argëtimit dhe sheshet e lojërave në ambiente të jashtme,me të njëjtat rregulla distancimi.

-**Në fazën e fundit do të hapen sërish restorantet dhe kafetë në ambiente të brendshme**,bizneset e argëtimit,struktura akomodimi për pushime dhe komplekse sportive.

Për sa i përket akordimit të orarit të ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve,hapja e tyre zhvendoset në orën 10:00 p.m me orar te zgjatur sipas rastit,**respektimi i distancave prej 2 metrash ndër person,përdorimi i maskës për personelin dhe klientët**, ndërsa rekomandohet mospërdorimi i ashensorëve,por nëse është e nevojshme atëherë lejohet përdorimi nga 40% të personave të parashikuar, ndërsa nëse dyqani disponon shkallë lëvizëse nuk lejohet përdorimi i ashensorit nga klientët.

Për dyqane berberi,parukeritë dhe qendrat estetike do të zbatohet **distanca prej 2 metrash ndërmjet vendeve të punës**. Hyrja e klientëve **vetëm me takim**.

Është i **detyrueshëm përdorimi i maskës për të gjithë dhe i dorezave njëpërdorimëshe** për punonjësit e qendrave estetike. Orari i funksionimit zgjerohet 7:00-22:00 çdo ditë dhe 7:00-21:00 të Shtunave.

4)Shkollat

-**Më 11 Maj hapen shkollat vetëm për Maturën** dhe më 18 Maj do të funksionojnë klasat e tjera te Liceut dhe Gjymnazet.

-Më 1 Qershor,dhe nëse gjithçka shkon mirë do të hapen kopshtet parashkollore dhe shkollat fillore.

-Çerdhet do të jenë të mbyllura.

-Komplekset sportive në natyrë,siç janë fushat e sportit,hapen dhe mund të pranojnë persona për stërvitje duke respektuar rregullat higjienike.Përkundrazi nuk do të funksionojnë palestrat e

mbyllura. Të mbyllura gjithashtu, do të mbeten edhe këndet e lojërave, hapja e të cilëve do të varet nga hapja e njësive shkollore të ciklit të ulët.